



Prishtinë, 12.10.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1608_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2348_08_22** i dt. 25.08.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 16.09.2022.

në seancën e mbajtur më datë 12.10.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit G. G., nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2348_08_22 i dt. 25.08.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 25.08.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2348_08_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 13.06.2022 lidhur me kontestimin e faturës së periudhës mars dhe prill 2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 55688247.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala G. G., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi i periudhës shkurt nuk mund të jetë real duke u bazuar në konsumin e me hershem;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi nr. 03220DPR-90079246 datë 25.03.2022 dhe nr. 04220DPR-90079246 datë 26.04.2022 me njehsorin elektrik nr. 55688247 nuk është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbalin e inspektimit nr. 2010219 datë 10.06.2022;



faturat nr. 03220DPR-90079246 datë 25.03.2022 dhe nr. 04220DPR-90079246 datë 26.04.2022; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 04.05.2022 dhe 07.06.2022; Përgjigja e KESCO-s datë 13.06.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 15.06.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2348_08_22 i dt.25.08.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, gjeti se fakturimi i periudhës mars dhe prill është real. Kështu KESCO ka vepruar konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim e sipër të rastit, ZRrE ka vërejtur se, pas ankesës së konsumatorit, me datë 10.06.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 55688247 ku TL=35522 kWh dhe TU=36465 kWh. Bordi konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe fakturuara në CCP për periudhën maj 2022 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit.

Bordi, më tej ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit nga fillimi, e në veçanti për periudhën 01/2022 deri më 06/2022 dhe konstaton se leximet e shpenzimeve janë bërë përmes AMR në baza të rregullta mujore dhe se në asnjë rast nuk ka evidentuar se nuk është bërë leximi i shpenzimeve mujore. Sipas listave të leximit konstatohet se shpenzimet mujore të konsumatorit për periudhat janë: 01/2022 TL= 3041 kWh dhe TU= 2819 kWh, periudha 02/2022 është TL=2140 kWh dhe TU=3016 kWh, periudha 03/2022 është TL=1694 kWh dhe TU=3591 kWh, periudha 04/2022 është TL=1937 kWh dhe TU=1541 kWh, periudha 05/2022 është TL=757 kWh dhe TU=360 kWh si dhe periudha 06/2022 është TL=444 kWh dhe TU=161 kWh. Po ashtu sipas rrjedhës së energjisë elektrike si dhe listave të leximit konstatohet se fakturimi i kWh për periudhën kontestuese mars dhe prill 2022 paraqet shpenzim real të konsumatorit si dhe vërtetohet se konsumatori edhe për periudhat e mëshme ka shpenzim më të lartë e që kjo përfshin periudhën/sezoin e dimrit pra periudhat jo kontestuese 10/2021 deri në periudhën 02/2022. Shpenzimet e konsumatorit për periudhën 10/2021 janë **2,964 kWh/muaj**, periudhën 11/2021 janë **4,168 kWh/muaj**, periudhën 12/2021 janë **6,302 kWh/muaj**, periudhën 01/2022 janë **5,860 kWh/muaj** dhe periudhën 02/2022 janë **5,156 kWh/muaj**. DMK ka shqyrtuar edhe shpenzimet e konsumatorit për periudha të mëshme dhe konstaton se konsumatori nuk ka dallim në shpenzime. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike me njehsorin e vjetër nr. 97394739 shpenzimet e regjistruara për periudha të njëjta kohore janë: periudha 10/2019 janë **1,427 kWh/muaj**, periudhën 11/2019 janë **3,411 kWh/muaj**, periudhën 12/2019 janë **5,898 kWh/muaj**, periudhën 01/2020 janë **8,220 kWh/muaj**, periudhën 02/2020 janë **6,422 kWh/muaj**, periudhën 03/2020 janë **5,694 kWh/muaj**, periudhën 04/2020 janë **4,489 kWh/muaj** si dhe periudhën 05/2020 janë **1,834 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri nr. 55688247 shpenzimet e regjistruara për periudha të njëjta kohore janë: periudha 11/2020 janë **3,839 kWh/muaj**, periudhën 12/2020 janë **6,300 kWh/muaj**, periudhën 01/2021 janë **6,633 kWh/muaj**, periudhën 02/2021 janë **5,617 kWh/muaj** periudhën 03/2021 janë **5,730 kWh/muaj**, periudhën 04/2021 janë **4,788 kWh/muaj**, si dhe periudhën 05/2020 janë **1,141 kWh/muaj**.



Bordi i ZRRE bazuar ne te gjitha analizat e bëra konstaton se faturimi i shpenzimeve te konsumatorit per periudhat kontestuese është në përputhje me nenin 28 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit G. G., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.